



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 20534 Prot.

Lezhë, më 03 . 12 . 2025

VENDIM

Nr. 108, Datë 26. 11. 2025

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PËRBASHKËT NDËRMJET KOMUNËS
CETINJE (PREJISTONICA CETINJE) DHE BASHKISË LEZHË PËR PROJEKTIN
“SMART LAND 2.0.- LËVIZSHMËRIA E QËNDRUESHME E NDËRLIDHUR ME
TRANSPORTIN PUBLIK NË ZONAT RURALE NË ADRIATIKUN JUGOR**

Mbështetur në ligjin Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", ligjin Nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore" si dhe Marrëveshjen e Partneritetit ndërmjet Komunës Cetinje (Prejistonica Cetinje - partneri kryesor) dhe Bashkisë Lezhë (partnere e projektit) për projektin "Smart Land 2.0- Lëvizshmëria e qëndrueshme e ndërlidhur me transportin publik në zonat rurale në Adriatikun Jugor", të protokolluar në Bashkinë Lezhë me Nr. 14907 Prot., datë 26.08.2025; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

Vendosi:

1. Miratimin e Marrëveshjes së Përbashkët ndërmjet Komunës Cetinje (Prejistonica Cetinje) dhe Bashkisë Lezhë për projektin "Smart Land 2.0- Lëvizshmëria e qëndrueshme e ndërlidhur me transportin publik në zonat rurale në Adriatikun Jugor".
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë Lezhë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikë 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/ 2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI





Nr. 20534/1 prot
Dt: 11.12.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT LEZHË
SEKTORI JURIDIK

Nr. 1191/4 Prot.

Lezhë, më 10.12.2025

Lënda: Konfirmim vendimi

KËSHILLIT TË BASHKISË LEZHË

Për Dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË LEZHË

Bazuar në nenin 16 pika 2 gërma "b" të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për prefektin e qarkut" të ndryshuar, ligjin nr.139/2015 "Për vetqeverisjen vendore" të ndryshuar, ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore", konfirmoj bazueshmërinë ligjore të vendimit nr.108, datë 26.11.2025 të Këshillit të Bashkisë Lezhë "Për miratimin e Marrëveshjes së Përbashkët ndërmjet Komunës Cetinje (Prejistonica Cetinje) dhe Bashkisë Lezhë për projektin "Smart Land 2.0-Lëvizshmëria e Qëndrueshme e ndërlidhur me transportin publik në zonat rurale në Adriatikun Jugor".

P R E F E K T I

Taulant MALSHI

